

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2914/5 prot.

Durrës, më 11/12 / 2025

VENDIM

Nr. 115, datë 11.12. 2025

PËR

"MIRATIMIN E PARAFINANCIMIT TË PROJEKTIT INTERREG/ "BLUE ECOSYSTEM"

Në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenit 49, gërma c, të ligjit nr.80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8 datë 17.02.2003 "Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e financimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marveshjeve me donatorë dhe kreditorë të huaj", Ligjin, nr.43/2016 Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 533, datë 04.10.2017 "Për miratimin në parim të marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit European, për programin Interreg V-B Adriatiko— Jonian (ADRION) 2014-2020", termat e referencës për "Interreg Euro-Med programme 2021 — 2027, Interreg IPA adriatic - ionian "IPA ADRION" 2021-2027", Rregullores Financiare të UAMD, Rregullores së funksionimit të Bordit të Administrimit, shkresën 2752 prot., date 25.11.2025 të Koordinatorit të projektit, Bordi i Administrimit

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit të shpenzimeve të projektit INTERREG/ "BLUE ECOSYSTEM" për periudhën 2025-2026, si vijon:
 - ✓ Vlera e financimit të projektit do të jetë për vitin 2025: 3 602 500 lekë, sipas zërave të përcaktuara në buxhetin e projektit.
 - ✓ Vlera e financimit të projektit do të jetë për vitin 2026: 1 752 500 lekë, sipas zërave të përcaktuara në buxhetin e projektit.
2. Burimi i financimit do të jetë nga të ardhurat e institucionit për vitin 2025.
3. Shpenzimet e kryera në kuadër të financimit të projektit të sipërcituar do të rimbursohen nga fondet e përfituara nga donatori në kuadër të projektit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet:
 - Administratori
 - Drejtorja e Administrimit Financiar

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

